

PROGRAMI I PUNES & BUXHETI 2022

VENDBURIMI I GAZIT DELVINE

PERMBAJTJA

1. HYRJE.....	2
1.1 Veprimtaria e DGC Janar-Dhjetor 2021.....	3
1.2 Veprimtaria e DGC Janar 2022.....	4
1.3 Konkluzione te aktivitetet per 2021.....	4
2. PROGRAMI I PUNES DHE BUXHETI 2022.....	5
3. KOSTOT OPERATIVE (OPEX).....	8
4. KOSTOT G & A.....	9
5. KOSTOT KAPITALE (CAPEX).....	10
5.1 Instalimi impjantit pastrimit dhe pajisjeve sip.....	11
5.2 Operacionet Hidrokarbure ne pusin Del-10.....	11
5.3 Operacionet Hidrokarbure ne pusin Del-14.....	11
5.4 Pergjithesimi gjeologjik dhe punimet G&G.....	12
5.5 Operacionet per shpimin e nje pusi te ri.....	12
6. PRODHIMI I GAZIT DHE KONDENSATIT DHE TE ARDHURAT.....	13
7. CASH FLOW 2022.....	14
8. MUNDESITE E MARKETINGUT TE GAZIT.....	15

Aneksi 1	Konstruksioni i pusit Del-12 (ST)
Aneksi 2	Perzgjedhja e zonave te stimulimit
Aneksi 3	Kompletimi per stimulimin me faza
Aneksi 4	Grafiket e Carjes Hidraulike me Faza
Aneksi 5	Ceshtjet Mjedisore
Aneksi 6	Plani i Pergjigjes ne Rast Emergjence

PROGRAMI I PUNES & BUXHETI 2022

VENDBURIMI I GAZIT DELVINE

1 HYRJE

Shoqeria Delvina Gas Company - Dege e Shoqerise se Huaj (DGC) eshte vijuesja e mbajtjes te drejtave te "Marrveshjes Hidrokarbure per Prodhimin, Zhvillimin, Kerkimin e Hidrokarbureve ne vendburimin e Delvines" dhe "Licence Marrveshjes per Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve ne Vendburimin e Delvines", te nenshkruar ne daten 19.07.2007 dhe "Instrumentit te Tranferimit te Interesave" midis Transatlantik Albania, Shoqerise "Albpetrol" sh.a., Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe DGC te dates 22.08.2016.

"Programi i Punes dhe Buxheti per Vitin 2022 per vendburimin e Delvines" eshte pergatitur nga shoqeria DGC dhe shoqerohet me pershkrime teknike administrative dhe financiare per aktivitetin e deritanishem te vitit 2021 dhe me programimin e aktivitetit per vitin 2022. "Programi i Punes dhe Buxheti per Vitin 2022 per vendburimin e Delvines" eshte ne perputhje me "Planin Zhvillimit te vendburimit te gazit Delvine" te miratuar ne vitin 2011, por duke marre ne konsiderate spostimin kohor ne realizimin e tij. Pavaresisht kohes se kaluar, "Plani i Zhvillimit te Vendburimit te Delvines", eshte ende ne perudhen fillestare te zbatimit te tij, ne te cilen parashikon keto aktivite kryesore;

- Nderhyrje ne puset vertikale egzistuese Delvina-4 dhe Delvina-12,
- Shpimin e nje pusi te ri horizontal
- Kompletimin dhe modernizimin e infrastruktures siperfaqesore per menaxhimin e prodhimit qe parashikohet nga punimet e mesiperme.

Ne zbatim te "Programit te Punes dhe Buxhetit te Vitit 2021", shoqeria DGC ka zhvilluar nje aktivitet mjaft intensiv administrative dhe operacional pergjate gjithe perudhes Janar-Shtator 2021.

Operacionet hidrokarbure ne vendburimin e gazit Delvine, u perqendruan ne kryerjen e remontit nentokesor ne puset Del-12 dhe Del-10, ne permiresime te infrastruktures dhe paisjeve siperfaqesore te vendburimit, ne realizimin e shpimit te devijuar te nje trangu te ri ne pusin Del-12, duke qendruar ne strukturen e Delvines dhe krijimin e

Pavaresisht ketyre problemeve qe shkaktuan vonesa ne kryerjen e operacioneve sic i permendem me siper, Delvina Gas Company arriti objektivin kryesor te saj, shpimin me sukses te trungut te devijuar dhe kompletimin e pusit Del-12 ST.

Punimet ne vendburimin e Delvines do te rifillojne ne Janar 2022, me operacionet e stimulimit me ane te carjeve hidraulike ne disa nivele dhe testimin e pusit Del-12 ST, prej te cilave do te sigurohen te dhena dhe rezultate mjaft te rendesishme per njohjen e metejshme te vendburimit

Punimet e kryera gjate vitit 2021 dhe te dhenat e fituara gjate ketyre punimeve, rriten ndjeshem sasine dhe cilesine e te dhenave per kete vendburim, qe duhet thene qe ishin mjaft te kufizuara ne sasi dhe cilesi dhe hapen nje perspektive te re per kete vendburim. Nder te dhenat kryesore te perfituara gjate ketij viti mund te permendim:

- Analizat e shllamrave te puseve Del-9 dhe Del-12 te marra gjate shpimit te tyre para vitit 1990 dhe te analizuara me metoden VAS nga kompania Baker Hughes;
- Matjet e karrotazhit te trungut te hapurte kryera nga kompanite Baker Hughes dhe GTK Oil;
- Analizat e shllamrave te pusit Del-12 ST te marra gjate shpimit te trungut te devijuar dhe te analizuara nga kompania Baker Hughes dhe krahasimi i tyre me rezultatet e shllamrave para vitit 1990;
- Te dhenat e marra nga kompania Geolog gjate procesit te shpimit te pusit.

Te gjitha keto te dhena mund te krijojne nje perfytyrim te ri per vendburimin. Ne keto kushte del e nevojshme nje pergjithesim i ri dhe me i plote mbi vendburimin e Delvines, ku te analizohen te gjitha te dhenat e disponueshme, si ato qe disponoheshin deri tani ashtu edhe te dhenat e reja te fituara gjate ketij viti dhe mbi kete baze te programohen punimet e ardhshme.

2 PROGRAMI I PUNES & BUXHETI 2022

Ky dokument perfageson Programin e Punes dhe Buxhetin per vitin 2022, te dorezuar nga Delvina Gas Company.

Programi i Punes dhe Buxheti per vitin 2022 per Vendburimin e Delvines, i paraqitur me poshte, bazohet mbi te dhenat e deritanishme, analizen e tyre dhe nevojen e vendburimit per punime dhe investime ne vijimesi.

Ky program shenon vijimin e veprimtarise te shoqerise Delvina Gas Company-Dege e Shoqerise se Huaj per kthimin ne prodhim te puseve Del-10 dhe Del-12, administrimin dhe marketingun e prodhimit te kondesatit dhe gazit dhe krijimin e nje kuptimi sa me te drejte e te plote te vendburimit te Delvines nga matjet, analizat dhe interpretimet e reja gjeologo-gjeofizike.

Operacionet Hidrokarbure te parashikuara ne kete Program Pune dhe Buxhet per vitin 2022, kane per qellim te krijojne kushtet per prodhimin dhe komercializimin e gazit dhe kondensatit ne vendburim, duke perdorur asetet egzistuese, pajisje prodhimi te reja, pajisje per pastrimin e gazit, si dhe venien ne prodhim te pusit Delvina 12 ST, pas testimit te tij dhe venien ne pune te pusit Delvina 10, nepermjet kryerjes se punimeve stimuluese, kryerjen e punimeve te remontit ne pusin Del-4, si dhe projektimit dhe fillimin e shpimit te nje pusi te ri (Del-34, Del-14 ose nje pus te ri), per te konfirmuar nivelet e pritshme te prodhimit nga nje pus horizontal ose i devijuar, i stimuluar ne disa faza, per te vazhduar me tej, mbi kete baze zhvillimin e plote te vendburimit te Delvines.


Ne Programin e Punes dhe Buxhetin per vitin 2022, Delvina Gas Company-Dege e Shoqerise se Huaj, ne kohen me te pershtateshme, rezervon te drejten e modifikimit dhe perditesimit te ketij programi dhe buxheti, nese nje gje e tille do te konsiderohet e nevojshme nga rezultatet qe do te perftohen nga testimi i pusit Del-12 ST.

Programi i Punes dhe Buxheti per vendburimin e Delvines per vitin 2022, parashikon vijimin e punimeve te programuara por te pa perfunduara te vitit 2021 dhe kryerjen e punimeve per te siguruar aktivitet te plote prodhimi gazi dhe kondensati, qe ne menyre te permbledhur paraqiten me poshte:

1. Kryerja e procesit te Carjes Hidraulike me Faza ne pusin Del-12 ST;
2. Testimi i pusit Del-12 ST dhe percaktimi i regjimit optimal te prodhimit te gazit dhe kondensatit nga ky pus;
3. Projektimi, prokurimi, instalimi dhe venia ne pune e pajisjeve te reja te prodhimit ne pusin Del-12 ST;
4. Projektimi, prokurimi dhe instalimi i impjantit per pastrimin e gazin nga H₂S dhe pergatitjen e tij per shitje;
5. Perfundimin e ndertimit te magazines fiskale dhe instalimin e pajisjeve te njevojshme per mundesimin e tregtimit te gazit dhe kondensatit;
6. Diskutimi i opsioneve, Pergatitja e Projektit Teknik te stimulimit dhe testimit te pusit Del-10;
7. Punime stimulimi, testimi dhe percaktimi i regjimit optimal te prodhit te pusit Del-10;
8. Projektimi, prokurimi, instalimi dhe venia ne pune e pajisjeve te reja te prodhimit ne pusin Del-10 si dhe tubacionet lidhese me impjantin e pastrimit dhe Magazine Fiskale;

Tabela e permbledhese e operacioneve hidrokarbure sipas kategorive, koha e parashikuar e fillimit dhe perfundimit, kohezgjatja dhe kostoja e tyre, paraqitet me poshte:

Plani Operacional i Delvina Gas per vitin - 2022



Nr.	Pershkrimi	Dt. fillimit	Dt. Perfund.	Kohezgjatja Dite	Kosto e Vleresuar (\$)
1	D-12 Carja Hidraulike me Faza	10 Janar	22 Janar	13	130,000.00
2	D-12 Testimi	28 Janar	22 Shkurt	25	340,000.00
3	D-12 Projektimi, prokurimi, instalimi impjantit te pastrimit te gazit	22 Shkurt	31 Maj	98	3,000,000.00
4	D-12 Projektimi, prokurimi dhe instalimi i pajisjeve siperfaqesore	22 Shkurt	31 Maj	98	500,000.00
5	D-12 Ndertimi i Magazines Fiskale	22 Shkurt	15 Maj	85	200,000.00
6	D-10 Hartimi Projektit Teknik dhe pergatitja e pusit per stimulim	25 Janar	15 Mars	42	50,000.00
7	D-10 Kompletimi i pusit	15 Mars	25 Mars	10	150,000.00
8	D-10 Stimulimi i pusit	1 Prill	10 Prill	10	200,000.00
9	D-10 Testimi	20 Prill	20 Maj	31	300,000.00
10	D-10 Projektimi, prokurimi dhe instalimi i pajisjeve siperfaqesore	20 Maj	31 Qershor	41	300,000.00
11	D-10 Projektimi, prokurimi dhe instalimi i tubacioneve lidhes	20 Maj	31 Qershor	41	200,000.00
12	D-4 Punime te remontit	1 Prill	20 Prill	20	250,000.00
13	D-4 Kompletimi i pusit	15 Prill	20 Prill	5	100,000.00
14	D-34/14H Projektimi i pusit	1 Maj	31 Tetor	184	200,000.00
15	D-34/14H Punime pergatitore	1 Shtator	15 Tetor	45	150,000.00
16	D-34/14H Prokurimi i materialeve dhe sherbimeve	1 Korrik	30 Nentor	153	5,000,000.00
17	D-34/14H Operacionet e shpimit	15 Nentor	31 Dhjetor	46	3,000,000.00
18	Sizmike Vertikale	1 Prill	31 maj	61	400,000.00
19	G&G, Studime te rezervuarit dhe mbeshetje teknike	2-Jan	31 Dhjetor	364	600,000.00

Totali 15,070,000.00
Rezerve (20%) 3,014,000.00
Totali + Rezerve 18,084,000.00

Grafiku kohor i kryerjes se ketyre punimeve paraqitet me poshte:

Operacioni	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
D-12 Kryerja e Carjes Hidraulike me faza	■											
D-12 Testimi	■	■										
D-12 Projektimi, prokurimi dhe instalimi i pajisjeve siperfaqesore		■	■	■	■							
D-12 Projektimi, prokurimi dhe instalimi i pajisjes pastrimit te gazit		■	■	■	■							
D-12 Projektimi, Prokurimi dhe Ndertimi i Magazines Fiskale		■	■	■	■							
D-10 Hartimi i projektit teknik dhe pergatitja e pusit per stimulim	■	■	■									
D-10 Kompletimi i pusit			■									
D-10 Stimulimi i pusit				■								
D-10 Testimi				■	■							
D-4 Punime te remontit				■								
D-4 Kompletimi i pusit				■								
D-10 Projektimi, prokurimi dhe instalimi i pajisjeve siperfaqesore					■	■						
D-10 Projektimi, prokurimi dhe instalimi i tubacioneve lidhes					■	■						
D-34/14H Projektimi i pusit					■	■	■	■	■	■	■	■
D-34/14H Punime pergatitore								■	■	■	■	■
D-34/14H Prokurimi i materialeve dhe sherbimeve							■	■	■	■	■	■
D-34/14H Operacionet e shpimit											■	■
Sizmike Vertikale				■	■	■	■	■	■	■	■	■
G&G, Studime te rezervuarit dhe mbeshetje teknike	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■

Operacionet kryesore te parashikuara se bashku me kostot respektive paraqiten ne tabelen e meposhtme:

	2022												
CAPEX	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHIATOR	TETOR	NETOR	DHJETOR	VITI 2022
Strukturimi, Testimi D-12	195,000	275,000											470,000
Implantimi I Gazit		1,000,000	1,000,000	500,000	500,000								3,000,000
Pajisje sipërfundesore D-12		200,000	100,000	100,000	100,000							0	500,000
Magazina fiskale		50,000	100,000	50,000									200,000
Kompletimi, strukturimi D-10		100,000	200,000	100,000									400,000
Testimi D-10				200,000	100,000								300,000
Pajisje sipërfundesore D-10					300,000	200,000							500,000
Remontimi dhe kompletimi D-4				250,000	100,000								350,000
Proektimi, përgatitja D-34/14					50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	100,000			350,000
Prokurimi D-34/14							500,000	500,000	1,000,000	1,000,000	2,000,000		5,000,000
Shpimi D-34/14											1,000,000	2,000,000	3,000,000
Studime, mbështetjeje teknike	100,000	100,000	100,000	100,000	100,000	100,000							600,000
Sisteme Vertikale				200,000	200,000								400,000
Totali	295,000	1,725,000	1,500,000	1,500,000	1,450,000	350,000	550,000	550,000	1,050,000	1,100,000	3,000,000	2,000,000	15,070,000

Kostot CAPEX te paraqitura ne tabelen e mesiperme, te lidhura me shpimin e pusit Del 34, D14, ose nje pusl te ri jane parashikime pasi vendimi per shpimin e ketij pusl, detyra e tij, konfigurimi, menyra e kompletimit dhe stimulimit, do te vendosen pas kryerjes se studimit pergjithesues per vendburimin e Delvines.

Me poshte po japim hollesi ne lidhje me sejcilin nga operacionet hidrokarbure qe parashikohen te kryhen ne vendburim sipas ketij Programi Pune dhe Buxheti per vitin 2022.

5.1 Installimi i Impjantit te pastrimit te gazit nga H₂S dhe pajisjeve siperfaqesore te prodhimit ne pusin Del-12 ST

Me perfundimin e punimeve te stimulimit dhe testimit ne pusin Del-12 ST, do te fillojne punimet per projektimin, prokurimin dhe instalimin e impjantit per pastrimin e gazit te prodhuar nga H₂S dhe per pajisjet siperfaqesore te prodhimit ne pusin Del-12.

Keto punime do të kryhen bazuar në të dhënat që do të merren gjatë periudhës së testimit të pusit, gjatë periudhës janar-shkurt 2022.

Totali i Kostove Kapitale qe parashikohet te kryhen gjate ketij operacioni arrin vleren prej rreth 3.75 milion USD.

Jane ne shqyrtim disa metoda te pastrimit te gazit nga H_2S si me poshte:

- Pastrimi i gazit nga H_2S me produkt mbetje sqfur pllakor;
- Pastrimi i gazit nga H_2S me produkt mbetje sqfur pluhuror;

- Pastrimi i gazit nga H_2S me metoden amine dhe prodhimi i gazit me perqindje te larte H_2S , i cili do te injektohet.

Sistemi Amine i pastrimit te gazit eshte studiuar mjaft nga DGC dhe mund te jete sistemi me i pershtatshem per pastrimin e gazit. Ky system eliminon mbetjet e squfurit, qe perbejne gjithmone nje problem. Sipas ketij sistemi Amine, gjate pastrimit te gazit nga H_2S dhe CO_2 , prodhohet gaz acid, me permbejtje 75% H_2S dhe 25% CO_2 . Ky gaz acid, do te perzjehet me nje pjese te gazit te prodhuar derisa permbajtja e H_2S dhe CO_2 te reduktohet ne 30% dhe 10% respektivisht dhe do te injektohet ne shtrese. Kjo per te siguruar nje jetegjatesi te tubacioneve dhe pajisjeve te injektimit te gazit.

Vendimi per metoden qe do te perdoret per pastrimin e gazit nga H_2S do te merret gjate muajve te pare te vitit 2022. Qe gjate muajve te fundit te vitit 2021, DGC eshte ne kontakt me disa kompani me te cilat po diskuton probleme teknike ne lidhje me pastrimin e gazit nga H_2S .

5.2 Operacionet Hidrokarbure ne Pusin Del-10 - Punime te kompletimit, stimulimit dhe testimit.

Qellimi i ketij operacioni eshte venia ne prodhim e pusit Del-10.

Operacionet kryesore qe do te kryhen ne kete pus perfshijne:

- Modifikimi i grykes se posit sipas standarteve;
- Kontrolli i integritetit te kollones se shfrytesimit dhe riparimi i saj ne rast difekti;
- Frezimin e tapes se cimentos dhe pastrimin e pusit;
- Percaktimin e zonave te stimulimit, perforimin e pjeses se tubuar dhe kompletimin e pusit per stimulimin e tij ne faza;
- Testimin e pusit;
- Projektimin, prokurimin dhe instalimin e pajisjeve siperfaqesore te prodhimit;
- Venien e pusit ne prodhim.

Totali i Kostove Kapitale qe parashikohet te kryhen gjate ketij operacioni arrin vleren prej rreth 0.7 milion USD

5.3 Operacionet Hidrokarbure ne Pusin Del-4 - Punime te remontit nentokesor

Qellimi i ketyre operacioneve eshte likuidimi i avarise se ndodhur ne pusin Del-4, si rezultat i te cilit ne pus ka mbetur nje paker dhe tubo prodhimi 2 3/8", kontrolli, pastrimi dhe larja e pusit.

Nuk eshte parashikuar kryerja e punimeve stimuluese ne kete pus pasi ai ndodhet afer kontaktit gaz-uje, por parashikohet qe ky pus fillimisht te perdoret si pus vrojtimi dhe me vone mund te konvertohet ne pus per injektimin e gazit ose ujit, nese do jete e nevojshme